



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 08 DATË 28.02.2022

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT NDIHMË PËR FAMILJE NË NEVOJË PËR VITIN 2022 NË MASËN 100.000 (NJËQIND MIJË) LEKË, PËR SECILËN FAMILJE TË BANUES NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË DIAML, PËR FAMILJEN E ZNJ.KLORENTINA VESHI DHE FAMILJEN E ZNJ.HAJRIE CAUSHI

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike „në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 41, Neni 53, 54 55, mbështetur në kërkesat e nenit 32 të Ligjit Nr 9936 datë 26.06.2008”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr 68/2017”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr 9355 datë 10.03.2005”Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Dimal Nr 82 datë 24.12.2021”Mbi miratimin e programit Buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2022”,

VENDOSI

Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

1. Të miratojë përdorimin e Fondit Ndhmë për familjet në nevojë, për familjen e Znj.Klorentina Veshi dhe familjen e Znj.Hajrie Caushi, për vitin 2022, në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë/familje
2. Të miratojë përdorimin e Fondit Ndhmë për familjet në nevojë ,për pagesën e qirasë mujore për familjet e Znj.Klorentina Veshi dhe familjen e Znj.Hajrie Caushi ,familje me gjëndje shumë të vështirë ekonomike,të përbëra nga 2 (dy) anëtarë,Klorentina Veshi është një nënë e vetme e divorcuar prej vitesh dhe pa mbështetje ekonomike,rezulton e papunë dhe djali i saj është me problem shëndetësore,fakt ky i cili e bënë të pamundur punësimin e saj.Aktualisht Klorentina jeton me qira por nuk i plotëson kushtet ekonomike financiare për pagimin në kohë të shumës përkatëse të qirasë mujore për arësyte të kushteve ekonomike në të cilat ndodhet janë ekstremisht të varfëra.

3. Gjithashtu familje e Znj.Hajrie Caushi dhe djali i saj manifestojnë problem shëndetësore mendor dhe jetojnë me qira,në pamundësi për pagesën e saj.
4. Qiraja mujore në masën 100.000(njëqind mijë) lekë, për secilën familje do të paguhet për 12 muaj.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit Nr 139/2015”Për Vetëqeverisjesn Venroe”,i ndryshuar.
6. Shënim:Fondi për vitin 2022,në masën 100.000 (njëqind mijë)lekë për secilën familje do të përballohet nga Fondi Ndihmë për familjet në nevojë i parashikuar në Buxhetin afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Dimal dhe buxhetin e detajuar për vitin 2022

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha

